




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 21.12.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.12.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1061, të datës 29.11.2018, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 7, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit të vitit 2018

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2018', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Sabit Bullatovci - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Eglantina Azemi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Aida Alimi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Qerim Gara - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Islam Shaban - Drejtor i Arsimit, anëtar;
 - 1.6 Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
 - 1.7 Sabri Xhigoli - Drejtor i Shkollës, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Krijuesin e vitit 2018'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së ARSIMIT dhe Arkivit.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 21.12.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.12.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1061, të datës 29.11.2018, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 8, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2018

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2018', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Albert Jasharaj - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Doruntina Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Migjen Kolshi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.4 Bashkim Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Fatlum Berisha - Zyrtar për Sport, anëtar;
 - 1.6 Ismet Breznica - Gjygjëtar i Futbollit, anëtar;
 - 1.7 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Sportistët e vitit 2018'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së ARSIMIT dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bir. str. 235
Data/Datum 24.12.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 21.12.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.12.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1888, të datës 17.12.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, mbështetur në kërkesën Nr. 02-070/05-0040179/18, të datës 11.12.2018, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, jep këtë:

P Ë L Q I M

Për subjektin afarist 'Kosmonte Foods' për realizimin e procedurave për vazhdimin e kontratës për marrjen në shfrytëzim të përkohshëm me qira të pronës nga Agjencioni Pyjor i Kosovës

1. I jepet 'Pëlqimi' subjektit afarist 'Kosmonte Foods', me pronar Lulzim Begaj në lidhje kërkesën Nr. 02-070/05-0040179/18, të datës 11.12.2018, për realizimin e procedurave për vazhdimin e kontratës me Nr. Ref: KE-1194/13, të datës 13.12.2013 për shfrytëzimin e përkohshëm me qira të pronës së evidentuar në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514003-00025-0, në Zonën Kadastrale Harilaç, në vendin e quajtur 'Shume kua eshkanit' nga Agjencioni Pyjor i Kosovës.
2. Zhvillimi dhe zgjerimi i biznesit në pronën e propozuar, e evidentuar në Ngastrën Kadastrale me Nr. P - 72514003-00025-0 në Zonën Kadastrale Harilaç, nuk është në kundërshtim me planet zhvillimore dhe strategjike të komunës dhe është zonë për zhvillimin e biznesit.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së BZHR, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së INSPK, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr. lag/Dr. str.	236	
Data/Datum.	24. 12. 2018	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		

Datë: 21.12.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.12.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1892, të datës 17.12.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 20, të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike Nr. 06/L-021, (Gazeta Zyrtare Nr. 03/2018), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Auditim të Brendshëm

1. Për formimin e 'Komitetit për Auditim të Brendshëm për periudhën 2019-2021', në përbërje prej tre (3) anëtarëve:
 - 1.1 Enver Bajçinca - ekonomist i diplomuar, Kryetar i Komitetit;
 - 1.2 Shaban Abazi - ekonomist i diplomuar, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - jurist i diplomuar, anëtar.
2. Komiteti për Auditim të Brendshëm, është organ këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit, Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq./Br.str.	237
Data/Datum	24.12.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	



Datë: 24.12.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.12.2018, pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur nga përfaqësuesi i Partisë Liberale Egjiptiane në Kuvendin e Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Aprovohet propozimi për punësimin e një personi të komunitetit egjiptian

1. Aprovohet propozimi i përfaqësuesit të komunitetit egjiptian për punësimin e një personi të komunitetit egjiptian në Shërbimin Civil të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Në Shërbimin Civil të Komunës së Fushë-Kosovës, kemi të punësuar dy e më shumë persona nga komunitetet tjera serb dhe ashkalinj dhe nuk kemi asnjë person të komunitetit egjiptian, andaj Kuvendi i Komunës e aprovon propozimin për punësimin e një personi nga radhët e komunitetit egjiptian, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së Administratës, Zyrës Komunale për Komunitete e
Kthim dhe Arkivit.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Bilstr.	238	
Datë/Datum.	24.12.2018	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 24.12.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.12.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1891, të datës 17.12.2018, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për hapjen e procedurave për ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të tjera në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2019

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 1891, i datës 17.12.2018, për hapjen e procedurave të tenderimit publik për 'Ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të tjera në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2019', lidhur me shumën e mjeteve financiare të planifikuara nga buxheti i komunës, në kodet e programeve dhe projekteve në kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve dhe investimeve kapitale për projekte si vijon:
 - 1.1 Nga organizata buxhetore Nr. 612, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime Nr. 13460 lejohen për shpenzim mjetet financiare në shumë prej 250,000.00€ në kodet e programeve: shëndetësia Nr. 73150, arsimit Nr. 92010, administrata Nr. 16302 dhe shërbimet publike Nr. 13460;
 - 1.2 Nga organizata buxhetore Nr. 612, programi Nr. 17502, bashkëfinancim i projekteve, Nr. 44684, lejohen për shpenzim mjetet financiare në shumë prej 125,000.00€.
2. Kryerja e procedurave tjera të tenderimit publik dhe sigurimi i mjeteve financiare nga pika një e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Administratës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Zyrës së Prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së ARSIMIT, Drejtorisë së SHPM, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Yjollca Konjusha

